

VENDIM
Nr.77, datë 7.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
“MAKSI ELEKTRIK” SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2006 - 31 DHJETOR 2006

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b; 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike ” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2006 - 31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për periudhën 1.1.2006 deri me 31.12. 2006, të jetë 5.1 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet “Maksi Elektrik” sh.p.k. dhe “KESH” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta